



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:968/25, Datë:01.08.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr.13/29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Ua 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve Rregullorja (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baqelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 140 të mbajtur me datë 24.07.2025 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I.** Aprovohet kërkesa e Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K) me Nr.643/25 datë 04.06.2025 për zgjatjen e periudhës së validimit të akreditimit edhe për një (1) vit akademik (nga 1 tetor 2025 - 30 shtator 2026) për programin e studimeve:
 - *Studime Profesionale, MSc 66 ECTS; (me specializim Parashikim Strategjik dhe Inovacion) (R).*
- II.** Zgjatja e validimit të akreditimit bëhet me kushtet dhe kriteret e njëjta të përcaktuara me vendimin e KShC-së Ref.:1323/22 datë 16.09.2022.
- III.** Institucioni i Arsimit të Lartë - Kolegji RIT Kosovo (A.U.K) mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të vendimit KShC-së Ref.:1323/22 datë 16.09.2022 dhe të këtij vendimi.
- IV.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji RIT Kosovo (A.U.K) ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) Nr.643/25 datë 04.06.2025 për zgjatjen e periudhës së validimit të akreditimit edhe për një (1) vit akademik (nga 1 tetor 2025 - 30 shtator 2026) për programin e studimeve:

Studime Profesionale, MSc 66 ECTS; (me specializim Parashikim Strategjik dhe Inovacion) (R).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 140-të, të mbajtur më datë 24.07.2025 ka shqyrtuar kërkesën dhe duke u bazuar në arsyeshmërinë e kërkesës, në të cilën Kolegji ka ofruar: dëshmi faktike dhe juridike me të cilat është akredituar/riakredituar programi në fjalë.

Kërkesa është bërë për vazhdimin e validimit të programit të studimit deri më 30 shtator 2027, bazuar në vendimin e mëparshëm të KShC-së Ref.:1323/22 datë 16.09.2022 të Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe vlerësimin e ATMAE (Association of Technology, Management, and Applied Engineering) e cila është e fokusuar kryesisht në SHBA.

Periodha e ri/akreditimit sipas ATMAE për programin në fjalë, ishte deri me 31.10.2026, si dëshmi kemi certifikatën e bashkangjitur për akreditimin e programit të lartshënuara.

Meqenëse vendimi për validim Ref.:1323/22 datë 16.09.2022 ishte lëshuar për periudhën 5 vjeçare, pra 1 vit më pak se sa akreditimi nga ATMAE, është bërë duke u bazuar në nenin 19 të UA 15/2018 për akreditimin e IAL-ve në Republikën e Kosovës e cila thotë "Kohëzgjatja e akreditimit programeve është jo më shumë se pesë (5) vjet", dhe tani edhe me Ligjin nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, përkatësisht me nenin 35, paragrafin 2. "Kohëzgjatja e riakreditimit të programit është tre (3) ose pesë (5) vjet".

KShC tani ka marr parasysh vlerësimin e ATMAE dhe ka vendosur që të zgjatet edhe për një (1) vit validimi i akreditimit për këtë program.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 140 të mbajtur më datë 24.07.2025, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin relevant të Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K) dhe duke u bazuar në kërkesën, dispozitat ligjore të lartcekura dhe kompetencat, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji RIT Kosovo (A.U.K);
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:846/25, Datë:10.07.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 139 të mbajtur më 30.06.2025, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet Kolegji RIT Kosovo (A.U.K) në nivel institucional, për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2025 - 30 shtator 2030).
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji RIT Kosovo (A.U.K) brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditim në nivel institucional.

Me qëllim të vlerësimit të institucionit për riakreditim në nivel institucional, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin RIT Kosovo (A.U.K).

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar me 19.05.2025, ekipi i ekspertëve gjatë vizitës ka konstatuar se nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit në nivel institucional, është vlerësuar Kolegji RIT Kosovo përmbushë: Plotësisht tetë (8) fusha të standardeve të akreditimit dhe Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit.

Faqe 1 nga 2

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 139-të, të mbajtur më datë 30.06.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit RIT Kosovo dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K.);
- MASIITI;
- Arkivit të AKA-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1761/24 Datë: 28/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 121, mbajtur më datë 06.03.2024 dhe kërkesës së parashtruar nga RIT Kosovo me 30.07.2024, mori:

V E N D I M

- I.** Validohet riakreditimi i programit të studimit i Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K) deri më 31 tetor 2026:
 - *BSc në Arte dhe Shkenca të Aplikuara 240 ECTS me kuotën maksimumi 200 studentë për vit akademik;*
- II.** Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III.** Obligohet IAL-së RIT Kosovo që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV.** Obligohet IAL-së RIT Kosovo të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimet e bartësve bëhen me vendim nga KShC.
- V.** Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji RIT Kosovo brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për validim të riakreditimit të programit të studimit si në paragrafin I të dispozitivit të këtij vendimi me bartësit e programit si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	BSc në Arte dhe Shkenca të Aplikuara	Linda Ziberi Edmond Muhaxheri Gent Carrabregu Leandrit Mehmeti Diellza Gashi Tresi Robert Muharremi Venera Demukaj Bislimi Albina Balidemaj

Kërkesa dhe materialet e nevojshme për shqyrtim i janë dorëzuar me kohë KShC-së dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të nevojshëm për validim KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi është marrë në bazë të certifikatave dhe dëshmime të ofruara si: 1) Faqet e para në gjuhët shqipe dhe angleze, 2) Tabelën me bartësit e programeve, 3) Listën e lëndëve dhe rezultatet e të nxëniet për programin, 4) Strukturën organizative, 5) Certifikatën e Akreditimit nga ATMAE, 6) Raportin e ekspertëve të ATMAE dhe rekomandimeve të dhëna nga ekspertët e jashtëm të vlerësimit/akreditimit nga ATMAE.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 121-të, të mbajtur më datë 06.03.2024, ka shqyrtuar kërkesën e Kolegjit RIT Kosovo, dhe duke ju referuar Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe raporteve, certifikatave dhe dëshmime të ofruara për riakreditimin e këtij institucioni përkatësisht programit BSc në Arte dhe Shkenca të Aplikuara nga agjencia e jashtme e akreditimit (ATMAE), vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit RIT Kosovo;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hashija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:1383/24 Datë: 12/07/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 124-të, mbajtur me datë 25.06.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e R.I.T Kosova (AUK) me nr.prot.1092/24 i datës 31.05.2024 për ndryshimin e emrit të programit Bachelor të Shkencave SOIS.
- II. Ndryshohet emërtimi i programit të studimit (titullit të diplomës), nga BSc në "Arte dhe Shkenca të Aplikuara", në **"Program të Individualizuar"**
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

IAL R.I.T (AUK) ka parashtruar kërkesë me nr.prot.0000/24 i datës 00.06.2024 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për ndryshimin e emrit të titullit të diplomës Bachelor të Shkencave SOIS, me arsyetimin e dhënë se ky ndryshim sipas tyre, do të ofroj fleksibilitet maksimal kurrikular për studentët në faza të ndryshme të rrugëtimit arsimor dhe se ky program karakterizohet më së miri si "i individualizuar" dhe jo si "i aplikuar.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 124-të mbajtur më datë 25.06.2024 ka shqyrtuar kërkesën e R.I.T (AUK) dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, pas administrimit të provave dhe gjendjes së vërtetuar faktike dhe juridike vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- R.I.T (AUK) ;
- MASHTI ;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hajrija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 585/23 Data: 02.05.23

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 111-të, të mbajtur më 14.04.2023, mori:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** kërkesa e Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K.) me Nr.Prot.2054/22 të datës 08.12.2022 për rivalidim të programit.
- II. **Validohet** akreditimi ndërkombëtar i Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K.) për periudhën tre (3) vjeçare (1 tetor 2023 – 30 shtator 2026) për programin e studimit:
 - *Informatikë dhe Teknologji Informative BSc 252 ECTS*, maksimumi 200 studentë për vit akademik.
- III. Numri i përcaktuar i studentëve sikur në paragrafin II aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) që deri me datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit.
- V. Obligohet Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programit të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VII. Institucioni i Arsimit të Lartë mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) në afatin ligjor me datë 08.12.2022 ka parashtruar kërkesë me Nr.Prot.2054/22 pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për rivalidimin e programit të studimit: Informatikë dhe Teknologji Informative BSc 252 ECTS, me stafin akademik bartës si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Informatikë dhe Teknologji Informative BSc, 252 ECTS. Rivalidim	Kamal Shahrabi Mimoza Polloshka Linda Ziberi Edmond Muhaxheri Charles Border Özcan Asilkan Debabrata Samanta

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 111-të, të mbajtur më 14.04.2023, ka shqyrtuar kërkesën e Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) dhe arsyet e cekura në kërkesë, vlerësimin, validimin nga agjencia amerikane e akreditimit "Association of Technology, Management, and Applied Engineering".

KSHC gjatë vlerësimit të programit është i bazuar në nenin 23 Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, në raportin e vizitës së ekipit të ekspertëve të "Association of Technology, Management, and Applied Engineering" realizuar me 21 deri 23 shtator të vitit 2022 dhe në certifikatën e akreditimit të lëshuar nga ATMAE.

Andaj KSHC duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, raportin dhe certifikatën e ATMAE, si dhe në kompetencat ligjore vendosi si në dispozitiv në këtij vendimi.,

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.)
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,


Prof. Asoc. Dr. Hajroja Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 16/09/2022, Ref.: 1323/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Udhëzimit Administrativ MASHT NR.08/2019 i datës 17.05.2019 për ndryshim dhe plotësimin e udhëzimit administrativ Nr.15/2018 dt 28.09.2018 për akreditimin e IAL-ve në Republikën e Kosovës dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 104-të, të mbajtur më 01.09.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Validohet** akreditimi ndërkombëtar i programit të studimit të Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) për periudhën 1 tetor 2022 - 30 shtator 2025:
 1. *Studime Profesionale, MSc 66 ECTS, me specializim Parashikim Strategjik dhe Inovacion, me maksimum 30 studentë për vit akademik.*
- II. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) që deri me datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ MASHT NR.08/2019 i datës 17.05.2019 për ndryshim dhe plotësimin e udhëzimit administrativ Nr.15/2018 dt 28.09.2018 për akreditimin e IAL-ve në Republikën e Kosovës dhe çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportoj dhe arsyetoj në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovet nga KSHC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për validim të akreditimit të programit të studimit;

- *Studime Profesionale, MSc 66 ECTS, me specializim Parashikim Strategjik dhe Inovacion, me maksimum 30 studentë për vit akademik.*

Për programin e akredituar si në dispozitiv të këtij vendimi, KSHC ka aprovuar listën e bartësve si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Studime Profesionale, MSc 66 ECTS, me specializim;</i> (Strategic Foresight and Innovation), Validim	Albina Balidemaj Fadil Sahiti

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 104-të, të mbajtur më 01.09.2022 ka shqyrtuar kërkesën e RIT Kosovo (A.U.K.) College dhe në bazë të certifikatave dhe dëshmive të ofruara për akreditimin e këtij programi nga Middle State Commission on Higher Education/MSCHE, kompetencat dhe referencat ligjore të cekura më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- RIT Kosovo (A.U.K.);
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Ass. Dr. Hashija Iaziri
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 02/08/2022 Ref.: 1035/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr.04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 103-të mbajtur më 26.07.2022, mori:

V E N D I M

- I. Korrigjohet vendimi 1575/20 dt.11.09.2020 me të cilin Validohet programi i studimit i RIT Kosovo (A.U.K.) College për periudhën 1 Tetor 2020 - 31 Shtator 2023. Korrigjimi bëhet në pikën I dhe ka të bëjë me numrin e studentëve, kështu që në paragrafin ku shkruan:
 - Informatikë dhe Teknologjitë Informative, BSc, 240 ECTS, *maksimum 50 studentë për vit akademik*, korrigjohet dhe ndryshohet numri në maksimum 140 studentë për vit akademik.
- II. Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pa ndryshuar.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

RIT Kosovo (A.U.K.) College me datë 19.07.2022 ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për rritjen e numrit të studentëve në programin e studimeve • Informatikë dhe Teknologjitë Informative, BSc, 240 ECTS, nga *maksimum 50 studentë për vit akademik*, në 200 student për vit akademik.

Meqenëse RIT Kosovo (A.U.K.) bazuar në Udhëzimin administrativ (MASHT) 08/2018 për ndrysimin dhe plotësimin e Udhëzimit administrativ nr.15.2018, nuk i nënshtrohet procesit të vlerësimit për akreditim nga AKA dhe duke marr për bazë validimin e këtij institucioni nga agjencia "The Middle States Commission on Higher Education", e cila është anëtare e Komitetit të Arsimit të Lartë (CHEA) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, KShC bazuar në kompetencat dhe fushën e përgjegjësisë si dhe rrethanat e reja të paraqitura në kërkesës, vendosi për korrigjim të vendimit 1575/20 dt.11.09.2020 për ndryshimin e numrit të studentëve si në pikën I të dispozitivit, bazuar në aplikacionin fillestar të RIT Kosovo (A.U.K.) dhe validimin e vitit 2020.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 103-të mbajtur më 26.07.2022 ka shqyrtuar kërkesën e RIT Kosovo (A.U.K.) College dhe arsyet e cekura në kërkesë, vlerësimin, validimin nga agjencia "The Middle

States Commission on Higher Education", bazuar në nenin 50 të Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- RIT Kosovo (A. U.K.);
- MASHTI;
- Arkivët të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnië Hoxhi
Kryetare e Këshillit Shikues të Çështjeve





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15/04/2022 Ref.: 475/02

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 97-të, të mbajtur më 05.04.2022, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) në nivel institucional, për periudhën tre (3) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim në nivel institucional. AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin RIT Kosovo (A.U.K.) me qëllim të vlerësimit në nivel institucional.

Vizita është organizuar më 08.02.2022, me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Melita Kovacevic, Ahmad Zargai dhe Christopher Bohlens.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) është vlerësuar se përmbushë: plotësisht pesë (5), dhe substancialisht gjashtë (6).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 97 të mbajtur më 05.04.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K.) dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K.);
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 11/09/2020 Ref.: 1575/20

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 83-të, të mbajtur më 02.09.2020, mori:

V E N D I M

- I. Validohet programi i studimit i Kolegjit AUK për periudhën 1 Tetor 2020 – 31 Shtator 2023:
 - Informatikë dhe Teknologjitë Informative, BSc, 240 ECTS, maksimum 50 studentë për vit akademik
- II. Obligohet Kolegji AUK që deri me datë 31 Tetor 2020 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

- I. Kolegji AUK ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për validim të programit të studimit të cekur në dispozitivin I të këtij vendimi. Vendimi është marrë në bazë të certifikatave dhe dëshmimeve të ofruara, rreth akreditimit dhe validimit të këtij institucioni nga agjencia "The Middle States

Commission on Higher Education”, e cila është anëtare e Komitetit të Arsimit të Lartë (CHEA) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit AUK
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.



G. Luboteni

Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosovo za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 29/07/2019

Ref.: 1371/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) në nivel institucional, për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022
- II. Riakreditohen programet e studimit:
 - Artet dhe Shkencat e Aplikuara, BSc, 240 ECTS, për periudhën 5 vjeçare 01.10.2019 – 30.09.2024, me nga 200 studentë për vit akademik.
 - Studime Profesionale, MSc, 60 ECTS për periudhën 3 vjeçare 01.10.2019 – 30.09.2022, me nga 35 studentë për vit akademik.
- III. Obligohet Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional dhe të programeve të studimit të cekura në dispozitivin I të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin RIT Kosovo (A.U.K.) më datë 16.05.2019 me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional dhe të programeve të studimit me

ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Magdalena Platis, Prof. Dr. Kristilina Tonnison dhe Mr. Mikus Dubickis (Student Expert)


Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K.) dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, konstaton se Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) përmbush në mënyrë substanciale standardet e akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit, prandaj rekomandon riakreditimin e këtij institucioni.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K.)
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

